



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 22, datë 30.03.2018

PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME RROGOZHINË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 35, datë 11.12.2012 "Për rinovim licence sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë" me vlefshmëri 4 vjet;
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë ka aplikuar për licencim me anë të shkresës nr. 130 prot. datë 28.08.2017, për efekt të përfundimit të afatit;
- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti Akt miratimi higjeno sanitar, ndërkohë që ishte sjellë vetëm raport analiza e burimeve nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Dosja u plotësua me shkresën nr.35 prot. datë 01.03.2018;
- Këshilli Bashkiak Rrogozhinë me vendimin nr. 41, datë 20.06.2017 ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. si pasojë e shtimit të kapitalit të njësive administrative Lekaj e Kryevidh që më parë zotëroheshin nga Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, por shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. ende nuk i ka reflektuar këto ndryshime në QKB;
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë faktikisht e kryen shërbimin në dy njësitë administrative Lekaj dhe Kryevidh;

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:
 - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Për dokumentin Ekstrakt Historik i Regjistrisë Tregtare në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. bazuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë detyrohet të paraqesë pranë ERRU ekstraktin e QKB të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a me:
Drejtues Ligjor dhe Drejtues Teknik Bujar Meraj
2. Operatori sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Rrogozhinë;
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.58, datë 05.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 22, DATË 30.03.2018, "PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
RROGOZHINË"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 05.11.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.03.2018 "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë (**UK Rrogozhinë**) me shkresën nr. 76 prot. datë 06.10.2019, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të sh.a Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.03.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a. z. Skënder Dedej, ka mbaruar studimet e larta në Inxhinieri mekanike në vitin 1996 ka shërbyer edhe më parë si drejtues ligjor i kësaj shoqërie nga viti 1990-1991 dhe nga viti 1998-2006.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 22, datë 30.03.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor Skënder Dedej”

“Drejtues Teknik Skënder Dedej”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.131, datë 11.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 58, DATË 05.11.2019 PËR "LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
RROGOZHINË PËR NDRYSHIM DREJTUESI LIGJOR DHE TEKNIK "

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence"(**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 11.11.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. (**UK Rrogozhinë**) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik.",

Vëren se:

1. Shoqëria UK Rrogozhinë me shkresën nr. 79 prot. datë 14.10.2020, me lëndë "Kërkesë për ndryshim licence" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik **Jo** në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. ERRU ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.03.2018 "Për licencimin e sh. a Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë", (**vendimi i KKRR nr. 58 i ndryshuar**) me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a. **nuk** plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi profilin e arsimit.

5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë mos përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë nuk është i bazuar ligjërisht dhe nuk plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 58, datë 05.11.2019 “Për licencimin e sh.a Ujësjetës Kanalizime Rrogozhinë për ndryshim drejtuesi teknik” nuk bëhet ndryshimi si më poshtë:

Ishte dhe mbetet

“Drejtues Ligjor Skënder Dedej”

“Drejtues Teknik Skënder Dedej”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.133, datë 06.04.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 22, DATË 30.03.2018, “PËR LICENCIMIN E
SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME RROGOZHINË”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 06.04.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.03.2018 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë (UK Rrogozhinë) me shkresën nr.34 prot. datë 11.03.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë" dhe shkresën nr.45 prot. datë 23.03.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë" ka paraqitur pranë ERRU kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.03.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a. z. Elis Kacani, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.
5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a. z. Geraldo Gjini ka mbaruar studimet e larta Master Profesional në Inxhinierin Hidroteknike në vitin 2015.
6. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efiçencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 22, datë 30.03.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor Elis Kacani”

“Drejtues Teknik Geraldo Gjini”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani